

## Informacion periodik mbi riskun Q1 -2024

**Tabela 4: Mjaftueshmëria e kapitalit**

### Informacion cilësor

Banka bën përlogaritjen e kapitalit regulator sipas kërkesave të rregullores "Për kapitalin rregullator të bankës", në fuqi nga data 30.06.2015.

### Informacion sasior

#### **RREZIKU I KREDISË**

Tabela më poshtë detajon zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". (Vlerat në Lekë)

<b>040</b>	<b>1.</b>	<b>Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)p.</b>	113,414,881,131.17
<b>050</b>	1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përfshirë pozicionet e titullimit	113,414,881,131.17
<b>060</b>	1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	4,101,486,286.06
<b>070</b>	1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-
<b>080</b>	1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësive të sektorit public	0.00
<b>090</b>	1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	-
<b>100</b>	1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-
<b>110</b>	1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	9,171,753,096.41
<b>120</b>	1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	47,191,376,771.17

130	1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	36,807,561,888.24
140	1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	3,599,720,403.04
150	1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme;	2,400,777,975.89
160	1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	2,764,938,488.29
170	1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-
180	1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	-
190	1.1.14	Zëra të tjerë	5,179,744,120.40
191	1.1.15	Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë	2,197,522,101.65
192	1.1.16	Ekspozime të kapitalit	-
200	1.2	Pozicionet e titullzimit SA	-
200*	1.2*	<i>nga të cilat: rititullzime</i>	
205	4	Pozicionet e titullzimit ERBA	-
205*	4*	<i>nga të cilat: rititullzime</i>	

## RREZIQET E TREGUT

Tabela më poshtë përmbledh kërkesën për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". (Vlerat në lekë)

210	2.	<b>Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut</b>	-
220	2.1	<b>Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes</b>	-
230	2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-
240	2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-
250	2.2	<b>Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)</b>	-
260	2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-
270	2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-
280	2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	-
290	2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	-
300	2.3	<b>Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm</b>	

## RREZIKU OPERACIONAL

Tabela e mëposhtme detajon kërkesën për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

310	3.	<b>Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional</b>	<b>22,653,905,258.81</b>
320	3.1	<b>Metoda e Treguesit Bazik (BIA)</b>	
330	3.2	<b>Metoda Standarde / Standarde Alternative</b>	22,653,905,258.81

### Tabelë 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

Fondet rezervë krijohen në momentin kur ekziston një evidencë objektive për humbjen. Evidencë objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është i zhvlerësuar përfshin të dhënat e mbikëqyrura, në bazë të ngjarjeve të mëposhtme:

- a) Vështirësi financiare të huamarrësit,
- b) Shkelje të kontratës,
- c) Falimentimi ose riorganizime të tjera financiare,
- d) Ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësit,
- e) Mashtrime nga ana e klientit.

Provigjonet sipas standardeve të Bankës së Shqipërisë përlllogariten në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara në rregulloren “Për Administrimin E Rrezikut Të Kredisë Nga Bankat Dhe Degët E Bankave Të Huaja”

Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar IFRS 9, RBAL kalkulon tre tipe të provigjoneve bazuar në ndryshimin e cilësisë të kredisë që nga njohja fillestare:

- **Faza 1** përfshin kreditë që nuk kanë pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare. Humbjet e pritshme 12-mujore janë humbjet e pritura të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e papaguara që pritet të ndodhin brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Kjo është humbja e tërë e kredisë e ponderuar nga probabiliteti që humbja do të ndodhë në 12 muajt e ardhshëm. Humbjet e pritshme të vlerësuara për tre skenar makroekonomik janë ponderuar humbjet mesatare të kredisë me probabilitetin e shfaqjes së skenarit përkatës.
- **Faza 2** përfshin kreditë që kanë pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare, por që nuk kanë evidencë objektive të zhvlerësimit. Për këto asete, fondi rezervë njihet në jetëgjatësi. Kjo është humbja e tërë e kredisë e ponderuar nga

probabiliteti që humbja do të ndodhë deri në jetëgjatësinë e kredisë. Humbjet e pritshme të vlerësuara për tre skenar makroekonomik janë ponderuar humbjet mesatare të kredisë me probabilitetin e shfaqjes së skenarit përkatës.

- **Faza 3** përfshin kreditë që kanë dëshmi objektive të humbjes në datën e raportimit. Fondi rezervë për kreditë është i barabartë me prodhimin e ekspozimit të kredisë me përqindjen e humbjes (si rezultat i metodave të brendshme statistikore).

Klientët individë dhe Micro të cilët punojnë ose operojnë në industritë më të prekura nga COVID, janë klasifikuar në Fazën 2 pavarësisht se kredia e tyre nuk ka shfaqur shenjat në rritjen e riskut të kredisë.

Duke filluar nga muaji Shtator 2020, klientët që kanë treguar performacë të mirë me pagesën në kohë të kredisë gjatë kësaj periudhe dhe bazuar në faktin që operojnë në industritë që nuk konsiderohen me risk të lartë, janë klasifikuar në Fazën 1.

### **Tabelë 7: Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard**

Në tabelën më poshtë mund të gjeni një informacion përmbledhës për secilën klasë të ekspozimit sipas klasifikimit në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” që përfshin:

- emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA);
- klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur Institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA)

a)	<b>KLASAT E EKSPOZIMIT</b>	<b>EMËRTIMI I KLASAVE TË EKSPOZIMIT</b>	<b>EMRI I INSTITUCIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT (ECAI)</b>
	A	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	B	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	C	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësive të sektorit publik;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	D	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	E	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-
	F	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	G	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	H	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj	FITCH, MOODY'S,

		portofoleve me pakicë (retail);	STANDARD & POORS
I		Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	-
J		Ekspozime (kredi) me probleme;	-
K		Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	-
L		Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
M		Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	
O		Zëra të tjerë	-
G/1		Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
G/2		Ekspozime të kapitalit	-

Tabela më poshtë detajon Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregullator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

<b>Njësia monetare: ALL</b>				
	<b>KLASAT E EKSPOZIMIT</b>	<b>EMËRTIMI I KLASAVE TË EKSPOZIMIT</b>	<b>EKSPOZIMI PARA APLIKIMIT TË TEKNIKAVE TË ZBUTJES</b>	<b>EKSPOZIMI PAS APLIKIMIT TË TEKNIKAVE TË ZBUTJES</b>
A		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	117,147,595,449.97	122,520,356,888.12
B		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-	-
C		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësive të sektorit publik	0.01	0.01
D		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	-	174,616,117.09
E		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	17,251,257,879.77	17,251,257,879.77
F		Ekspozime ose ekspozime të	27,713,499,698.13	27,713,499,698.13

		mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;		
G		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	77,040,824,070.80	69,623,153,953.80
H		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	55,669,516,720.99	55,180,762,107.00
I		Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	8,702,831,437.49	8,702,831,437.49
J		Ekspozime (kredi) me probleme;	2,502,949,175.19	2,296,685,168.49
K		Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	1,993,677,645.61	1,993,677,645.61
L		Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-	-
M		Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	-	-
O		Zëra të tjerë	12,549,729,338.26	12,549,729,338.26
G/1		Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë	7,528,329,384.15	7,528,329,384.15
G/2		Ekspozime të kapitalit	-	-
		Ekspozime te zbritshme nga kapitali rregullator	2,452,049,797.00	2,452,049,797.00

**Tabelë 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut**

Me qëllim zbutjen e rrezikut të kredisë Banka Raiffeisen përdor disa lloje kolateralesh, të cilat po i detajojmë më poshtë:

<b>Mbrojtje financuar Kredisë</b>	<b>e e</b>	Kolateral Financiar	Cash
			Letra me vlerë
		Prona të Patundshme	Prona të Patundshme Komerçiale (CRE)
			Prona të Patundshme Rezidenciale (RRE)
		Llogari të arkëtueshme	Kalim i të drejtave të të gjitha llogarive të arkëtueshme
			Kalim i të drejtave të llogarive të arkëtueshme nga

	Kolaterale të tjera fizike	një kontratë specifike
		Peng mbi kuotat e biznesit
		Peng mbi makineri
		Peng mbi Inventar
		Peng mbi llogari të arkëtueshme
		Peng mbi pasuri të luajtshme
	Peng në makina	
	Sigurim Jete	
<b>Mbrojtje e pafinancuar e Kredisë</b>	Garanci	Garanci Shtetërore
		Garanci Bankare
		Garanci Korporatore

Banka ka disa procedura të brendshme të cilat rregullojnë vlerësimin dhe administrimin e kolateraleve. Këto politika kanë bazën në parimet e mëposhtme:

#### 1. Prona duhet të ketë një titull ligjor të vlefshëm:

Titulli ligjor i kolateralit duhet të jetë i dokumentuar shumë mirë dhe banka sigurohet që inskripti mbi pronën në fjalë të jetë ligjërish i imponueshëm sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë.

#### 2. Vlerë e qendrueshme:

Kolaterali duhet të ofrojë vlerë të qendrueshme të paktën për afatin maksimal të kontratës së kredisë. Ky kusht monitorohet dhe vlerësohet rregullisht. Në rast të rënies së vlerave banka merr masa të menjëherëshme për përmirësimin e situatës.

#### 3. Vlerë e kthyeshme në cash:

Kolaterali duhet të ketë një vlerë e cila mund të kthehet në cash në një kohë të arsyeshme, kjo e provuar nga eksperiencia në Republikën e Shqipërisë. Nëse likuidimi i pronës është i dyshueshëm, atëherë kolaterali vlerësohet me vlerë 0.

#### 4. Pak ose aspak korrelacion:

Korrelacioni i gjendjes financiare të klientit me kolateralin e marrë për kredinë duhet të jetë shumë i pakët. Sa më i lartë të jetë korrelacioni midis të dyjave aq më e ulët është vlera e kolateralit. Një shembull i korrelacionit të madh është përdorimi i një Letre me Vlerë e lëshuar nga Kompania X si kolateral për një kredi që i jepet kësaj kompanie.

Llojet kryesore të ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë janë si më poshtë:

- Qeveritë qendore dhe bankat qendrore;

- Qeveritë lokale;
- Bankat multilaterale të zhvillimit:
  - the International Bank for Reconstruction and Development;
  - the International Finance Corporation;
  - the Inter-American Development Bank;
  - the Asian Development Bank;
  - the African Development Bank;
  - the Council of Europe Development Bank;
  - the Nordic Investment Bank;
  - the Caribbean Development Bank;
  - the European Bank for Reconstruction and Development;
  - the European Investment Bank;
  - the European Investment Fund;
  - the Multilateral Investment Guarantee Agency;
  - the International Finance Facility for Immunization;
  - the Islamic Development Bank;
  - the Inter-American Investment Corporation;
  - the Black Sea Trade and Development Bank;
  - the Central American Bank for Economic Integration;
  - the CAF-Development Bank for Latin America;
- Organizatat Ndërkombëtare:
  - Komuniteti Evropian;
  - Fondi Monetar Ndërkombëtar;
  - the Bank for International Settlement;
  - the European Financial Stability Facility;
  - the European Stability Mechanism;
- Njësitë e sektorit publik;
- Banka dhe institucione financiare të vlerësuara me një gjendje të mirë financiare;
- Korporata dhe kompani të tjera të cilat janë analizuar nga Banka Raiffeisen dhe janë vlerësuar në gjendje të mirë financiare.

<b>LLOJI I MBROJTJES SË FINANCUAR</b>	<b>EKSPOZIMI NË RASTIN E PËRDORIMIT TË MBROJTJES SË FINANCUAR</b>
Kolateral financiar	2,565,311,182.45
Netimi në bilanc	-
Marrëveshjet tip të netimit/kompensimit	-



Mbrojtje të tjera të pranueshme	-
<b>LLOJI I MBROJTJES SË PAFINANCUAR</b>	<b>EKSPozIMI NË RASTIN E PËRDORIMIT TË MBROJTJES SË PAFINANCUAR</b>
Garanci	5,547,377,555.24
Kundërgaranci	-
Derivatvët e kredisë	-

**Tabelë 9: Rreziku i kredisë së kundërpartisë (çdo tremujor)**

N/A

**Tabelë 10: Titullzimi (çdo tremujor)**

N/A

**Tabela 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm**

**Informacion Cilësor:**

Mjaftueshmëria e kapitalit për rrezikun e tregut llogaritet në bazë të Kapitullit VII të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", sipas kushteve të mëposhtme:

- a) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivitetit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;
- b) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

Bankat janë subjekt i detyrimeve të këtij kreu, nëse tejkalohet një nga kufijtë e përcaktuar më lart.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është llogaritur si shuma e rrezikut të Pozicionit (Rreziku i Përgjithshëm dhe Rreziku Specifik), rrezikut të Përqendrimit në librin e tregtueshëm,

Rreziku i Shlyerjes dhe rrezikut të Kursit të Këmbimit. Llogaritjet janë bazuar në metodën standarde.

- Rreziku i Pozicionit për titujt e borxhit:
  - Rreziku i Përgjithshëm për titujt e borxhit është përlllogaritur duke u bazuar në Metodën e Maturitetit të titujve.
  - Rreziku Specifik për titujt e borxhit bazuar në Shkallën e Cilësisë së Kredisë. Rreziku Specifik për librin e tregtueshëm për fundin e muajit Dhjetor është 0, pasi libri i tregtueshëm përbëhet vetëm nga tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë Shkallën e Cilësisë së Kredisë 1 (RW është 0%).

Për muajin Dhjetor 2023 kërkesa për kapital për titujt e borxhit është 0 pasi ekspozimi i bankës nuk e tejkalon kufirin e përcaktuar në rregulloren e RMK për të llogaritur kërkesë për kapital.

- Rreziku i Përqendrimit në Librin e Tregtueshëm për fund muajin Dhjetor është 0, pasi pozicionet e rrezikut në librin e tregtueshëm të bankës nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të lejuar për ekspozimet e mëdha, të përcaktuara në “Rregulloren për Menaxhimin e Ekspozimeve të mëdha të bankave” (libri i tregtueshëm i bankës përbëhet tërësisht nga tituj të borxhit të Qeverisë Shqiptare.)
- Rreziku i Shlyerjes për shlyerjet e tipit Dorëzim Kundrejt Pagesës (Delivery vs Payment) ose anasjelltas. Rreziku i shlyerjes për transaksionet DVP është 0 për portofolin e fund muajit Dhjetor.
- Rreziku i kursit të këmbimit, përlllogaritet në rastin kur pozicioni total neto i hapur valutë është më i lartë se 2% i kapitalit rregullator. Për fundin e muajit Dhjetor 2023, pozicioni total neto i hapur valutë rezulton në 1.37% i kapitalit rregullator dhe rrjedhimisht banka nuk ka përlllogaritur kërkesë për kapital për këtë rrezik, si më poshtë vijon:

#### Informacion Sasior (LEK):

	<b>Ekspozime të ponderuara me rrezik</b>	<b>Kërkesa për Kapital</b>
<b>Shuma e rreziqeve të tregut</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shuma e rrezikut të shlyerjes</b>	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
<b>Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-	-
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-	-
Rreziku i kursit të këmbimit	0	0
Rreziku i Investimeve në mallra	0	0

**Tabela 12: Rreziku Operacional**

Informacion Cilësor
<p>(a)</p> <p>Banka Raiffeisen përdor Metodën Standarde për përllogaritjen e kërkesave për kapital dhe Aktiveve të ponderuara me Risk për Rrezikun Operacional. Sipas kësaj metode, të ardhurat Bruto (mesatarja e tre viteve të fundit) të bankës ndahen në tetë linja biznesi me risk operacional (sipas përcaktimeve të rregullores së Bankës së Shqipërisë, Neni 185 tabela 30). Pastaj, secila ndarje e të ardhurave bruto shumëzohet me faktorin beta që i korrespondon linjës së biznesit (<math>\beta</math> janë faktorë të përcaktuar). Më pas rezultati total - <math>\sum G_i \&amp; \beta_n</math> - përcakton kërkesën për kapital për rrezikun operacional.</p> <p>Aktivitet e ponderuara me risk përllogariten duke shumëzuar kërkesën për kapital me një koeficient prej 12.5</p> <p>Përllogaritja e rrezikut operacional bëhet me baza vjetore ndërsa raportimi bëhet me baza tremujore. Pra këtu paraqitet rreziku operacional llogaritur mbi bazën e të dhënave të bilancit të pa audituar të muajit Dhjetor 2023.</p>
<p>(b)</p> <p>Kërkesa për kapital (EC) = Lekë 1,812,312,420.70</p>

**Tabela 14: Rreziku i normës së interesit në librin e bankës.**

**Informacioni Cilësor:**

Banka Raiffeisen ka vlerësuar burimet/format e ndryshme të rrezikut të normës së interesit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të ardhurat neto nga interesat ose ekspozimin në librin e bankës.

Banka vlerëson dhe raporton ndjeshmërinë e të gjithë pozicioneve në librin e bankës ndaj luhatshmërisë së normave të interesit. Për të realizuar këtë vlerësim banka aplikon një skenar, i cili supozon një shock (shift 200 basis point) ndaj kurbës së kthimit, pra supozon një ndryshim të normave të interesit prej 200 basis point, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara. Efekti që rezulton në ekspozimin e librit të bankës krahasohet kundrejt kapitalit rregullator. Ky raport duhet të jetë nën 20% në mënyrë që banka të mos konsiderohet tepër e rrezikuar ndaj rrezikut të normave të interesit.

Burimet/format e rrezikut të normës së interesit përfshijnë:

- a. rrezikun e riçimit;
- b. rrezikun e kurbës së kthimit;
- c. rrezikun bazë; dhe
- d. rrezikun e opsioneve.

Raporti për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës mbulon të gjithë pozicionet e Librit të Bankës të ndjeshme ndaj normave të interesit. Raporti fokusohet në monedhat kryesore (konsiderohen të tilla nëse përbëjnë mbi 5% të aktiveve totale): ALL, EUR, USD dhe të tjerë. Pozicionet janë të ndarë sipas llojit të produktit dhe llojit të normës (normë fikse kundrejt normës së ndryshueshme). Pozicionet shpërndahen në intervalet kohore përkatëse si më poshtë:

- Pozicionet me normë fikse janë caktuar në intervalin kohor sipas maturimit të tyre;
- Pozicionet me normë të ndryshueshme janë caktuar sipas datës së ardhshme të rishikimit të normës së interesit;
- Pozicionet me maturitet të papërcaktuar ose për të cilat nuk njihet periudha e ndryshimit të normës së interesit apo kjo periudhë nuk mund të përcaktohet me siguri, shpërndahen duke u bazuar në metodologjinë e brendshme të bankës “Modelimi i Çmimeve të brendshëm dhe Rrezikut të Normës së Interesit për produktet me maturitet të papërcaktuar/produktet të administrueshme”. Përcaktimi i këtij modeli bazohet kryesisht në volume historike, normat historike të interesit dhe modelit të brendshëm të likuiditetit;
- Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat, në pasiv të bilancit, shpërndahen sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:
  - a. në intervalin kohor “at sight” (menjëherë/pa afat) vendoset një përqindje fikse (25%) e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat;
  - b. në intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” në “4-5 vjet” vendosen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve që përmban intervali, llogaritë e mbetura (75%) e atyre të përfshira në shkronjën “a” më sipër;
- Rezerva e detyrueshme në lekë pranë Bankës së Shqipërisë caktohen në zonën kohore “deri në 1 muaj”, ndërsa rezerva e detyrueshme në monedhë të huaj (USD) konsiderohet si pozicion jo i ndjeshëm ndaj rrezikut të normës së interesit;
- Kreditë me problem caktohen në intervalin kohor “2-3 vjet”.

Raporti për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës për llogaritet me frekuencë tremujore.

**Informacioni Sasior- Mars 2024:**

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	
IRR		Monedha	Shuma
		1	2
2.	NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT		1,484,602,645
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		28,044,904,003
4.	(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		5.29
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 1	ALL	48,562,595
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 2	USD	- 93,770,163
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 3	EUR	- 1,301,402,530
1.15.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 15	OTHER	- 137,992,547

**Tabela 15: Rreziku i Likuiditetit.**

**Informacioni Cilësor:**

Në përputhje të plotë me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, Raiffeisen Bank përllogarit, monitoron dhe raporton me baza ditore raportin që shpreh nivelin e aktiveve likuide përkundrejt pasiveve afatshkurtra, të njohur ndryshe edhe si raporti i “Treguesve të Likuiditetit”. Referuar rregullores, si zëra aktuale likuide dhe shumë likuide në përllogaritjen tonë janë konsideruar zërat e aktivitetit si më poshtë:

- a. arka;
- b. llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;
- c. bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”;
- d. 80 (tetëdhjetë) për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”;
- e. tituj “të investimit” të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj;
- f. 80 (tetëdhjetë) për qind të titujve të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, të kësaj dispozite, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”;
- g. llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare;
- h. depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë;

- i. hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë (përfshihet llogaria 157 “hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);

Të gjitha aktivet e mësipërme janë konsiduar të tilla duke qenë se mbi to nuk ekziston asnjë angazhim/marrëveshje që e detyron bankën të mos i përdori ato lirisht dhe në mënyrë të pavaruar sa herë që mund të lind nevoja për likuiditet.

Duke konsideruar të dhënat e përlogaritura përgjatë muajit Mars 2024 vërejmë që vazhdojmë të kemi një situatë shumë të mirë të likuiditetit të bankës në tërësi, për nivel total monedhash, monedhën kombëtare, edhe për monedhat e huaja në total.

### Informacioni Sasior – Mars 2024 (në mijë LEK):

Kodi	AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA	LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
1	Arka	3,182,676.3	1,012,664.1	2,345,843.9	828,800.9	7,369,985.2
2	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë	4,519,862.0	505.4	268,773.4	-	4,789,140.9
3	Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës	204,041.4	-	-	-	204,041.4
4	80 për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e	-	-	-	-	-
5	Letra me vlerë “të investimit” të Qeverisë Shqiptare	127,143.5	-	-	-	127,143.5
6	80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare	41,779,862.4	-	-	-	41,779,862.4
7	Bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të	-	-	-	-	-
8	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera	0.1	408,588.2	141,097.8	51,233.6	600,919.8
9	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare	-	7,181,361.0	16,541,496.0	3,867,642.3	27,590,499.3
10	Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me	-	-	-	-	-
11	Letrat me vlerë “të tregtueshme”/“të vendosjes” të	-	-	-	-	-
12	Letra me vlerë “të tregtueshme”/“të vendosjes” të	-	-	-	-	-
13	Letra me vlerë “të tregtueshme”/“të vendosjes” që nuk	-	-	-	-	-
14	Letra me vlerë “të investimit” me maturim të mbetur	-	-	7,706,450.2	-	7,706,450.2
15	Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së riblerjes,	-	-	-	-	-
<b>A</b>	<b>TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE</b>	<b>49,813,585.8</b>	<b>8,603,118.7</b>	<b>27,003,661.4</b>	<b>4,747,676.8</b>	<b>90,168,042.7</b>
<b>B</b>	<b>TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT</b>	<b>127,185,232.0</b>	<b>17,265,480.8</b>	<b>107,151,088.4</b>	<b>5,348,239.6</b>	<b>256,950,040.8</b>
<b>C</b>	<b>TREGUESI I LIKUIDITETIT (në %)</b>					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen	<b>39.17%</b>				
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat	<b>31.10%</b>				
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)	<b>35.09%</b>				